



Viti i VII<sup>-të</sup> i Botimit, Nr.1,  
Qershorë 2016

# DALLIMET GJUHËSORË NË LIGJËRIMIN MEDIATIK PARA DHE PAS TRANZICIONIT NË SHQIPËRI

Elona Limaj

Departamenti i Gjuhës Angleze, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University

Adresë kontakti: [e\\_limaj@yahoo.com](mailto:e_limaj@yahoo.com)

## Përmbledhje

Qëllimi i këtij studimi është të identifikojë dhe të analizojë dallimet në ligjërimin mediatik para dhe pas viteve '90-të, duke u bazuar në artikujt e gazetave shqiptare në kohë të ndryshme. Është zgjedhur si objekt studimi gjuha e gazetave, pasi gjuha e medias ka tërhequr gjithmonë vëmendjen e gjuhësisë, në veçanti të gjuhësisë së aplikuar dhe sociolinguistikës.

Për të kuptuar se si ndryshon gjuha e përdorur para dhe pas viteve '90-të në ligjërimin mediatik, është krijuar një tërësi tekstesh, ku kemi mbledhur artikuj duke i ndarë në dhjetëvjeçarë, ndërkohë që studimi është fokusuar kryesisht në periudhën 1984-2014, në mënyrë që të sigurohej një sistem kërkimor i specializuar për një analizë sa më të plotë. Në këtë hark kohor përfshihet edhe viti 1990, si pikë referimi për ndryshimin e sistemeve politike në Shqipëri.

Për sa i përket metodologjisë, në këtë punim është përdorur analiza e tekstit dhe interpretimi për të treguar ndryshimet në ligjërim mediatik. Sigurisht që ka edhe referenca nga materiale të vlefshme të studimeve të rëndësishme në këtë fushë.

Rezultati është ndryshimi gjuhësor në disa rrafshet e sistemit të shqipes, ku duket stili i lirshëm i periudhës pas tranzicionit dhe gjuha e drunjtë e periudhës së komunizmit.

Si konkluzion, ligjërimi mediatik nuk mund të shihet i ndarë nga situata sociale dhe ai paraqet realitetin.

**Fjalë çelës:** ligjërim, media, komunizëm, demokraci, dallime, gjuhë.

## *LANGUAGE DIFFERENCES IN MEDIA DISCOURSE BEFORE AND AFTER TRANSITION IN ALBANIA*

### **Abstract**

The scope of this study is to identify and analyze the differences in the media discourse before and after the '90-ies, based on the Albanian newspapers, in various periods of time. The object of the study is the language of newspapers, because this speech has always

attracted the attention of linguistics, in particular regarding applied linguistics and sociolinguistics.

To analyze the change of language used before and after the transition in the Albanian media discourse, we have collected a total of texts, where the articles have been divided into decades, whereas the study is mostly focused on news items belonging to 1984-2014 period, in order to provide a specialized research system for a complete analysis. This period of time includes the 1990, as a point of reference for the change of political systems in Albania.

Regarding the methodology, the text analysis and interpretation are the methods used to show differences in the media discourse. Certainly, the study consists of valuable material extracted from important studies in this field.

The result is language differences in several aspects of Albanian language system, where it is noted the free style of the post-communist period and the wooden language of communism era.

In conclusion, media discourse cannot be treated separately from the social situation, and it clearly presents the reality.

**Keywords:** discourse, media, communism, democracy, differences, language.

## Hyrje

Të gjithë mendojmë që folës të ndryshëm flasin të njëjtën gjuhë dhe janë të barabartë midis tyre kur flasin dhe të gjithë mendojmë që komunikimi është simetrik. Por gjuha nuk ekziston e ndarë nga përdoruesit e saj. Ligjërimet nuk ekziston në mënyrë të pavarur nga folësit e saj. Gjuha ndryshon në kohë, hapësirë, bazuar në klasat apo shtresat e ndryshme të shoqërisë dhe sipas situatave konkreteve. Gjuha e përdorur nga një komunitet i caktuar pasqyron tiparet e tij, mënyrën e jetesës dhe opinionet. Gjuha formon perceptime dhe pikëpamje të realitetit (10). Gjuha dhe opinionet e shprehura në media ndikojnë në mënyrë të ndërsjellë te njëra-tjetra. Ekzistojnë të njëjtat norma, të cilat rregullojnë shprehjen e mendimeve në shtyp që ndikojnë mbi fjalët. Por, nga ana tjetër, çdo opinion i shprehur në media do të ketë në dispozicionin e tij një fond të mirëpërcaktuar fjalësh që do të përbëhet nga kodi i bartësit dhe i transmetuesit.

Megjithatë, debati mediatik nuk do të thotë që një person është i lirë të thotë çdo gjë. Ligjërimi mediatik ndikohet nga gjuha e institucioneve shtetërore dhe rrethana të caktuara. Në këtë drejtim, një gjë e tillë u pasqyrua edhe në aspektin gjuhësor. (7)

Gazetarët përdorin fjalë për të arritur qëllimet e tyre që përfshijnë përhapjen e informacionit, i cili mund të ketë të bëjë me identitetin e tij social dhe kulturor, si dhe me rolin e tij në kompleksitetin e ndërveprimeve sociale ku ai është i përfshirë.

Ndërkohë që Labov (2014) merr parasysh identitetin shoqëror të pjesëmarrësve dhe mjedisin shoqëror të shkëmbimit gjuhësor. Ai vë në dukje që varietetet e gjuhës ndikohen nga pikëpamjet sociale.

## Gjuha në media gjatë periudhës komuniste

Përdorimi ideologjik i fjalëve ose modifikimi i përmbajtjes së tyre për shkak të ndërhyrjes së grupeve politike ose shtresave shoqërore të caktuara për të vepruar në përputhje me përkatësinë, politikën dhe pikëpamjet e tyre, është një fenomen i pranishëm në faza të ndryshme të historisë së shoqërisë njerëzore, por është bërë më evident dhe përgjithësues sidomos në një kohë kur në një vend është vendosur një regjim i veçantë politik (totalitar ose autokratik). Kjo ka ndodhur në

Shqipëri gjatë periudhës 1944-1990 kur si rezultat i totalitarizmit, ideologjia marksiste-leniniste dhe filozofia e saj sunduan të gjithë jetën e vendit dhe arritën të depërtonin në çdo shoqëri shqiptare të kohës duke politizuar gjithçka, e si rezultat, edhe gjuhësinë.

Gjuha përpara viteve '90-të ishte plot me klishe ideologjike, fraza të gatshme. Vihet re gjithashtu një ligjërim i ngjashëm nga të gjithë gazetarët. Për shkak të izolimit dhe censurës për një kohë të gjatë të fjalëve me një përmbajtje të pranueshme nga regjimi, publiku, gazetarët, aktorët e komunikimit në përgjithësi ishin të privuar nga njohja dhe përdorimi i një leksiku të nevojshëm për të artikuluar opinionin përtej kufijve kulturorë dhe gjuhësorë të kornizës politiko-juridike të kohës. Në këtë drejtim, debati mediatik karakterizohet nga përdorimi i frazave politike, kryesisht të bazuara në situatën politike të një periudhe të caktuar.

Në shtypin dhe median e një periudhe të caktuar përdoren vetëm ato fjalë që shprehin përmbajtje plotësisht të përcaktuar dhe të njësuar politike. Të menduarit jo vetëm që përballlet me pengesa gjuhësore shtesë, por gjithashtu nuk mund të vetëpërcaktohet qartësisht, si rrjedhojë e mungesës së fjalëve shprehëse autentike. Metaforikisht, mund të themi që “të menduarit vuan”. Mesazhi nuk mund të shprehet i plotë, sepse burimet dhe transmetuesit e tij nuk kanë atë sistem të kodifikuar të shenjave që mund të lejojnë përmbajtjen semantike të shprehet lirisht (7; 8; 11). Gjuha shqipe nuk ka mungesë të fjalëve të nevojshme apo të strukturave të ligjërimin për të shprehur të gjitha llojet e mesazheve, pavarësisht sesa të ndërlikuara mund të jenë. Gjetja e fjalëve të duhura nuk është e thjeshtë. Veçanërisht, nëse një gjë e tillë nuk është puna e një institucioni të tërë gjuhësor, por është në duart e një individi - gazetari - që dëshiron të vendosë marrëdhënie të qarta me audiencën e tij mediatike. Ne duhet të marrim në konsideratë edhe problemin e frekuencës së përdorimit të fjalëve politike të pranishme në debatin mediatik në përgjithësi. Ky quhet fenomeni i “bombardimit” me të njëjtat terma politike brenda një periudhe të caktuar kohore. Sa më i rëndësishëm të jetë mesazhi i transmetuar nga një fjalë brenda kësaj periudhe, aq më shpesh përdoret ajo fjalë.

### **Gjuha në media pas viteve '90**

Një nga tiparet kyçe të medias në Shqipërinë post-komuniste të periudhës së para të tranzicionit është që të gjitha partitë politike arritën të krijojnë një organ të denjë shtypi interesant për lexuesin, që ka arritur të mbijetojë. Politizimi i madh i shtypit është gjithashtu një fakt i dallueshëm në jetën mediatike të shoqërisë shqiptare post-komuniste (5).

Gjuha pas viteve '90-të është më e hapur ndaj strukturave gjuhësore, neologjizmave dhe fjalëve shprehëse.

### **Ndryshimet gjuhësore para dhe pas viteve '90-të**

Një tjetër tipar është fuqia e gazetave në përhapjen e mesazheve politike dhe propaganda e partive politike.

Shtypi, media, publikimet, sistemi arsimor dhe të tjera, në një moment të dhënë ofrojnë vetëm një univers terminologjik të caktuar për të shprehur mesazhe të ndryshme, realitete shoqërore të caktuara dhe fillojnë të përjashtojnë nga qarkullimi komunikativ të gjitha shenjat e tjera gjuhësore rivale. Një nga tezat antropologjike më të cituara e shkruar në vitin 1929 nga Eduard Sepir thotë që “gjuha në një mënyrë të fuqishme kushtëzon të gjithë të menduarin tonë për problemet dhe proceset shoqërore”. Si rezultat, gjuha e përdorur në këto organe u ndikua nga stili i gjuhës politike.

Fokusi i këtij studimi është një tërësi tekstesh që përbëhet nga artikuj të shtypit të shkruar. Ata janë mbledhur duke u bazuar në parime të përcaktuara, që mbulojnë kryesisht periudhën 1984-2014, me qëllim që të sigurohej një analizë të plotë për të pasqyruar fenomenin leksiko-gramatikor të ndryshimeve gjuhësore në artikujt e gazetave para dhe pas viteve '90-të.

Ky punim analizon ndryshimet gjuhësore në debatin mediatik para dhe pas viteve '90-të në pjesë të ndryshme të sistemit gjuhësor:

- a) Në sintaksë, para viteve '90-të përdorehin të gjitha me shumë fjali më pjesë të nënrenditura dhe lidhëza, plot me kishe politike dhe propagandistike, fraza të gatshme:

- *“Po atëherë pse s’vihet në binare së pari nga organet dhe organizata-bazë, të Partisë ky drejtim, ky “nen” i lëvizjes, por rri gati i palëvizur numri i këtyre mungesave në Valias, në Mushqeta, në Proforma? (Zëri i Popullit 1984) .*

- *“Të kritikosh indiferentizmin, egoizmin, mendjemadhësinë dhe shfaqje të tjera të psikologjisë mikroborgjeze në disa rreshta të shkruara bukur dhe me kujdes do të thotë të luftosh vetëm fillimin e shfaqjes së një koncepti të mbetesh në një kuadër të ngushtë dhe të mos kërkes rrënjët e tij në këtë kohë, kur siç thekson shoku Enver “Ka ardhur koha të mprehim më shume tehun e goditjes sonë kundër tyre”. (Zëri i Popullit 1986)*

- *“Posa u njohën nëpërmjet shtypit me projekt-direktivat e kongresit të 6-të të PPSH mbi planin e pestë pesëvjeçar, nëpër sektorët, brigadat, dhe skuadrat e NBSH Pogradec filloi diskutimi i tyre.” (Zëri i Popullit 1986)*

Nga ana tjetër pas viteve '90-të, fjalitë kanë qenë më të thjeshta. Pas viteve '90, fjalitë janë të shkurtra, të udhëhequra edhe nga stili i sotëm i gazetareve, i karakterizuar nga fjalitë e përmbledhura.

*“Specialistët e Drejtorisë sqaruan se numri i administratorëve që do të mbikëqyrnin provimet e Maturës Shtetërore është vendosur në përputhje me numrin e maturanëve” (Panorama 2006)*

*“Pranohet kërkesa e Madhit për mosshqyrtimin e katër neneve”. (Panorama 2006)*

*“Duket se PS po tregohet më aktive në konkretizimin e marrëveshjes së arritur dy ditë më parë.” (Panorama 2005)*

Vihet re një përdorim i formave veprorë në periudhën para viteve '90. Edhe fakt se ishte e nevojshme të përcaktohej personi që kryente veprimin. Ndërkohë që format pasive janë më të pranishme në periudhën pas viteve '90. Format veprorë dhe joveprorë të foljeve të përdorura në ligjërimin mediatik kanë të bëjnë me mënyrën se si kryhet veprimi dhe kush e kryen atë. Përdorimi i një foljeje veprorë apo jo reflekton qëndrimin e autorit nga incidentit, ngjarjes, procesit, veprimi. Po ashtu, ekziston një përdorim i konsiderueshëm i fjalive pyetëse, i ndikuar edhe nga aspekti ideologjik për shkak të nevojës për të ngritur pyetje.

Vëmë re edhe praninë e përgjithësimeve, të tilla si: *rinia, femra e re, të gjithë, e reja.*

b) Në morfologji, vihet re përdorimi i prapashtesave të tilla si: *ist, izëm*, i ndikuar kryesisht nga politika: *ist (ballist, komunist, fashist), izëm (realizëm, socializëm)*, por pas viteve '90 këto fjalë nuk janë aq të shpeshta sa më përpara.

Gazetarët shkruanin duke përdorur një numër të madh mbiemrash para viteve '90: *disiplinë e shëndoshë, element i shëndoshë ose i sëmurë, unitet i çeliktë*. Ndërsa tani kemi tendencën e përdorimit të një numri më të vogël mbiemrash, pasi këto nuk ishin të natyrshëm, por të detyruar

për t'u përdorur për të nxjerrë në pah propagandën.

c) Në leksikologji vihet re një modifikim i karakterit ngjyruës të përmbajtjes së fjalës, i influencuar nga faktorët jashtëgjuhësorë, nën ndikimin e ideologjisë së asaj periudhe (1; 2; 3) .

Disa fjali shoqëroreshin me një ngjyrim negativ ose nuk përdorshin më. Ndërkohë që fjalë apo kuptime të reja u futën në përdorim për shkak të ideologjisë së sistemit. Të tilla janë fjalët: *kulak, kooperativist, bashki, plan 5-vjeçar*.

Kuptime të reja të fjalëve ekzistuese:

**bulevard:** *“diçka që u përshtatet shijeve të këqija mikroborgjeze”*

**fidanishte:** *“mjedis shoqëror ku përgatiten e edukohen të rinjtë e të rejtat për të vijuar në të ardhmen atë që kanë bërë paraardhësit e tyre.”*

**njollë politike - njeri me njollë:** *“ndikim i dëmshëm i botëkuptimit, ideologjisë, moralit të shoqërisë së vjetër në ndërgjegjen e njerëzve të shoqërisë sonë socialiste.*

**armik:** *“ai që është kundër interesave të klasës, të partisë, të atdheut e të socializmit dhe që lufton e vepron kundër tyre”.*

Ligjërimi mediatik i periudhës para viteve '90 është plot me shprehje shabllon, të tilla si: *“tejkalimin e shifrave në disa zëra, tejkalimin e planit, arritjen e rendimenteve të larta, të përsosim figurën morale në luftën kundër shfaqjeve të huaja.*

Pas viteve '90 kemi shprehje më të gjalla, si për shembull: *ndjej nervin e demonstratës, nuk do t'ia hedhin dot Maturës Shtetërore, s'mund të këtë firmën përfundimtare, performancë e lartë, zbeh shpresat* .

Në media artikullohet gjuha publike, por edhe audienca gjithashtu ka fjalën e saj. Të dyja anët shprehin mendimet e tyre jo me gjuhën e tyre të brendshme, por me një gjuhë dhe informacion të censuruar, natyrshëm të modifikuar me eufemizma sipas një deontologjie të përcaktuar normative me kode etike dhe institucionale të përdorura nga media, dhe që mbrohen nga ligji dhe etike. Ligjërimi mediatik është jashtëzakonisht konkret dhe ka terminologjinë e vet modeste, si një përzierje e termave të madha kryesisht nga fjalori politik i së shkuarës, pjesërisht të huazuara nga kultura liberale politike anglo-saksone e kohëve klasike, ndërsa nga ana tjetër është ndërtuar në një mënyrë metaforike nëpërmjet përpjekjeve të guximshme autodidakte.

Struktura e gazetave shqiptare nuk konsiston në të dhëna sociologjike krejtësisht rastësore. Ajo ka qenë rezultat i një sërë ndryshimesh në shtypin shqiptar, e ndikuar nga një proces i tërë dhe fenomen i ri. (5; 9)

Sapir and Wharf kanë paraqitur në tezën e tyre të quajtur *Teoria e Relativitetit Gjuhësor*, sipas së cilës strukturat e gjuhës kushtëzohen nga struktura psikologjike dhe sociale e shoqërisë, duke ndikuar edhe në konceptet e njerëzve për kohën dhe hapësirën, p.sh. struktura e një gjuhe përcakton ose ndikon shumë mbi mënyrat e mendimit dhe sjelljes karakteristike të kulturës ku flitet. Kjo teori i përshtatet plotësisht situatës mediatike dhe regjimeve politike në Shqipëri. Gjuha mund të ofrojë një formë perceptimi me ndihmën e leksikut dhe sintaksës së saj. Leksiku shërben për të perceptuar në mënyrë të përzgjedhur botën e vërtetë, ndërsa sintaksa u ofron njerëzve mundësinë për të komunikuar për kohën, hapësirën, marrëdhëniet midis individëve, etj. Pikërisht kjo ide, e cila thekson se gjuha ndikon në perceptimet dhe modelet mendore të atyre që e flasin duke u kushtëzuar në vizionin e tyre mbi botën, është njohur si teoria e Sapir-it dhe Wharf-it (14) .

Në një kuptim të gjerë metodologjik, shoqëria nuk është gjë tjetër veçse komunikimi ndërmjet

individëve që janë pjesë e saj. Komunikimi nuk mund të realizohet jashtë matricës kulturore të shoqërisë, ndërsa shoqëria nuk është një substancë e ngurtë, por shumë e komunikimeve që realizohen brenda saj (15).

### **Konkluzione**

Ligjërimi mediatik jo vetëm që pasqyron “realitetin”, por gjithashtu ndërton një përkufizim hegjemonik të asaj që pranohet si “realitet”. Në të vërtetë, procesi i ndryshimit të gjuhës dhe diferencimi në kohë e hapësirë ka dy përbërës themelorë: një njohës, që lidhet me karakteristikat strukturore të gjuhëve, dhe tjetri është i lidhur me përdorimin e gjuhës nga folësit.

Folësi përdor fjalën për të arritur qëllime që mund të përfshijnë informacionin, por gjithashtu mund të kenë të bëjnë me identitetin e tij social dhe kulturor dhe rolin e tij në kompleksitetin e ndërveprimeve shoqërore në të cilat është përfshirë.

Por kapacitetet e pafundme shprehëse të një gjuhe kombëtare dhe përdorimi i gjuhës në median totalitare janë dy gjëra të ndryshme.

Në një kohë kur të folurit në gjuhën shqipe po përjeton një dinamizëm të kapaciteteve të pafundme të krijuara nga kuadri demokratik i të shprehurit, disa gjuhëtarë po përpiqen të formulojnë debatin gjuhësor që i përshtatet këtij realiteti.

Me gjithë evidentimin e disa rezultateve kyç të këtij punimi, prapëseprapë druaj të them se kam mundur të paraqesë thellësisht të gjitha kompleksitetin dhe dinamikën e problemeve që lidhen me gjuhën në media.

### **Referenca**

1. Scruton R. (2007) *Dictionary of Political Thought*, New Edition, The Palgrave Macmillan
2. Thomai J. (2009) *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, Tiranë, Instituti i Gjuhësisë
3. Samara M. (2008) *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*, Tiranë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë
4. Hudson A. R. (2002) *Sociolinguistika*, Tiranë, Shtëpia Botuese “Dituria”
5. Fevziu B. (1996) *Historia e Shtypit Shqiptar*, Tiranë, Shtëpia Botuese “Marin Barleti”
6. Shkurtaj Gj. (2009) *Sociolinguistikë e shqipes, Botimi i dytë*, Tiranë, Shtëpia botuese “Morava
7. Fuga A. (2008) *Media, Shoqëria dhe politika*, Tiranë : 55-60, Botimet Dudaj
8. Fuga A. (2010) *Monolog*, Tiranë, Botimet Dudaj
9. Borici H., Marku M. (2008) *Historia e Shtypit Shqiptar: 224-233*, Tirane, SHBLU
10. Baldi B. (2006) *Opinione Pubblica: Un potere fragile*, Edizioni dell’Orso, Alessandria
11. Fuga A. (2014) *Komunikimi Masiv*, Tiranë, Botimet Dudaj
12. Oliver B. (2007) *Shkenca e komunikimit*, Tiranë, Shtëpia Botuese “Papyrus”
13. Labov W. (2014) *Cognitive Linguistics*, Philadelphia/Amsterdam : 1-52, Cambridge Press .
14. Sapir E., Wharf B. (1921) *An introduction to study of speech*, Harcourt , Brace,
15. Magret E. (2010) *Sociologjia e Komunikimit dhe Mediave*, Tiranë, UET press dhe Papyrus

**MATERIALET E BURIMEVE TË VJELA****ZËRI I POPULLIT****1984**

- *Ekspozitë që na fton për meditime, Astrit Nuri, Sadri Rrahmani, 11 janar 1984, Nr. 9, fq. 3*
- *Drita e Komanit, Nadja Xheblati, 1 janar 1984, Nr. 1, fq. 4*
- *Kush i shmanget ballafaqimit, Frano Caka, 11 nëntor 1984, Nr. 271, fq. 2*
- *“Guximtarë” të vonuar, Filip Cakuli, 23 gusht 1984, Nr. 202, fq. 3*

**1985**

- *Shah/ Lojëra të gjalla e me nivel, Kristaq Andoni, 12 mars 1985, Nr. 60, fq.*
- *Shpenzimet që fshihen pas vështirësive të motit, Halil Bucpapaj, 7 shkurt 1985, Nr. 32, fq. 1,*
- *Shërbimet me “gjysmë dite”, Duro Mustafaj, 13 tetor 1984, Nr. 246, fq. 2*

**1986**

- *Drejtuesit mund të nxisin aksionin ose të dalin edhe vetë prej tij, Nadja Xheblati, 5 qershor 1986, Nr. 134, fq. 3.*
- *Rinia e luftës, Fahri Balliu, 5 maj 1986, Nr. 10, fq.3*
- *Pranë njerëzve, të kulturuar, kurajozë, Musa Mulqini, 2 prill 1986, Nr. 78, fq. 2*

**1990**

- *Si u përgjysmuan mungesat në ndërmarrjen e ndërtimit në Burrel, Frano Caka, 20 korrik 1990, fq. 1, Nr. 172*
- *Prodhimi ndiqet çdo ditë, kurse kontratat si 3-mujor, Halil Bucpapaj, 25 korrik 1990, fq. 3, Nr. 177*
- *Kur organizata gjen vetveten, nuk përsërit e dublon punën e të tjerëve, Valentina Leskaj, fq. 3, Nr. 309*

**1992**

- *Cilët janë “pushtetmbajtësit komunistë” në Tiranë? .. Luan M. Rama, 13 mars 1992, fq. 1, Nr. 27*
- *Transparencë për hallet apo ....., Merita Ndreka, 13 maj 1992, fq. 3, Nr. 99*
- *Të zgjedhim objektivat e fushatës, Thanas Dino, 24 prill 1992, fq. 1, Nr. 50*
- *Së shpejti do të shpartallohet me sukses një grup tjetër armiqësor, Thoma Gëllci, 23 shkurt 1992, fq. 3, Nr. 21*

**1993**

- *Tabllo e hidhur dhe e përditshme, Jeta Orgocka, 10 nëntor 1993, fq. 3, Nr. 250*
- *Shqetësim për liritë dhe të drejtat e njeriut, Florinda Dushi, 24 tetor 1993, fq. 1, nr. 240*

Dallimet gjuhësorë në ligjërimin mediatik para dhe pas tranzicionit në shqipëri

- *Zv. ministri i Rendit flet me gjuhën që foli një ditë më parë drejtori i burgjeve, Ardian Myslimi, 23 shtator 1993, fq. 1, Nr. 222*
- *Të falem për nderin Itali!, Zenepe Lukaj, 4 shtator 1993, fq 3, 206*

### PANORAMA

#### 2004

- *Arratisja fut belgët në sherr, Ernest Bunguri, 29 maj 2004, fq 11, Nr. 593*
- *Thirrjet ndërkombëtare vidhen, Elizabeta Ilnica, 12 maj 2004, fq. 7, Nr. 576*
- *Procesi i parë shqiptar në Strasburg, Rezear Xhaxhiu, 11 maj 2004, fq. 8, Nr. 575*
- *Kapen 500 kilogramë mariuanë, Vladimir Karaj, 5 maj 2004, fq. 5, Nr. 529*

#### 2005

- *SHBA: Shtatë kushtet për zgjedhjet në Shqipëri, Arben Cejku, 18 maj 2005, fq. 8, Nr. 948*
- *LZHK mbledh të pakënaqurit e PD, Eva Gjura, 11 maj 2005, fq. 5, 941*
- *Zbulohet koka e një gruaje në Erzen, Trazhgim Sokolaj, 4 maj 2005, fq. 11, Nr. 934*
- *Tare e Xhuvani në skenën socialiste, Luljeta Progni, 4 maj 2005, fq. 5, Nr. 934*

#### 2006

- *“Nova Istra”: Ilirët traktat në poezitë e Lekës, Anila Mema, 16 shkurt 2006, fq. 5, Nr. 1219*
- *ryeministrit thyen disiplinën dhe dinjitetin, Florenc Bakillari, 24 qershor 2006, fq. 8, Nr. 1348*
- *Berisha “neglizhon” Di Stasion, Bledar Hoti, 25 janar 2006, fq. 5, Nr. 1197*
- *Kushtetuesja rrëzon socialistët, Aristir Lumezi, 22 qershor 2006, fq. 5, Nr. 1346*

#### 2012

- *Dështon zyrtarisht shitja e Albpetrolit, Nertila Maho, 11 dhjetor 2012, Nr. 4831, fq 7*
- *Vilëz, pamje shokuese nga shtëpia e Nazimes, Elisabeta Ilnica, 10 shtator 2012, Nr. 3522, fq. 11*
- *Nazimja, SMS-të që i tregonte Fiqiriut se ishte shtatzënë, Elizabeta Ilnica, 14 shtator 2012, Nr. 3547, fq. 5*
- *Nazimja s’ka qënë shtatzënë, Trazhgim Sokolaj, 4 shtator 2012, Nr. 3557, fq. 11*

#### 2013

- *Taksat e reja për makinat, Nertila Maho, 23 maj 2013, Nr. 3409 fq 5*
- *Votimi, PD merr shumicën në KQZ, Aristir Lumezi, 16 prill 2013, Nr. 3776, fq. 3*
- *SHBA: KQZ partiake, minoi të drejtat e qytetarëve, Fation Binjaku, 20 prill 2013, Nr. 3772, fq. 2*

#### 2014

- *Buxheti 2015, 14 milionë dollarë për ish-pronarët, Aristir Lumezi, 3 nëntor 2014, Nr. 4332, fq. 4*
- *Lufta mes ditarësh e fotosh në Bibliotekën Kombëtare, Alma Mile, 1 dhjetor 2014, Nr. 4361, fq. 21*
- *Debati me dyer të mbyllura, Brace kritika për ministrat, 25 nëntor 2014, Nertila Maho, Nr. 4355, fq. 3*